

## Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

### Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 23-29.12.2024

Janë testuar gjithsej 128 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=109) është shënuar një rritje prej 17,4%.

Nuk janë regjistruar raste pozitive.

*Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 23-29.12.2024*

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
23.12.2024	31	0	0,0%
24.12.2024	24	1	4,2%
25.12.2024	19	0	0,0%
26.12.2024	21	0	0,0%
27.12.2024	24	2	8,3%
28.12.2024	1	0	0,0%
29.12.2024	8	0	0,0%
<b>Gjithsej</b>	<b>128</b>	<b>3</b>	<b>Mesatarja 1,8%</b>

Gjatë javës së kaluar (23-29.12.2024), nuk është raportuar rast i vdekjes si pasojë e COVID-19.

### **GJENDJA KUMULATIVE ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Gjatë vitit 2024, deri më 29.12.2024, janë regjistruar gjithsej 1.749 raste me COVID-19. Në muajin nëntor të vitit 2024 (12) regjistrohet një rënie prej 78,6% për dallim nga një muaj më parë.

Gjatë vitit 2024, deri më 29.12.2024, janë testuar gjithsej 13.291 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

### **Vlerësimi i rrezikut**

Shkalla e ulët e transmetimit të SARS-CoV-2, rënia e numrit të raportimeve dhe testimeve ndikon në aftësinë për vlerësimin e gjendjes epidemiologjike. Popullata e EU/EEA në përgjithësi ka një nivel të konsiderueshëm të imunitetit hibrid (vaksinim/vaksinim me booster doza), që ofron një mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

### **Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll**

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).<sup>1</sup>

**Shkup, 30.12.2024**

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse**

**Instituti i Shëndetit Publik**

---

<sup>1</sup> <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>